



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 136 Datë 04.11.2020

“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016 “ Për Prefektin e Qarkut “, Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” kreu III, pika 1, germa ë, dhe kreu III pika 3,germa ç,Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e tij, vendosi me datë 04.11.2020 me 21 vota pro 0 vota kundër 0 vota apstenim.

VENDOSI :

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi I kat** në pronësi të **z. Sabri Pasha** njësia administrative Selishtë (fshati Murrë) në shumën totale **1218420** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **690120** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **528300** lekë.
3. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër i dëmtuari është trajtuar në shumën prej **60921** lekë (10% e 50 % të vlerës totale të dëmit) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar, sipas Vendimit të Keshillit Bashkiak nr 76 date 02.08.2017
4. Për pjesën tjetër të vlerës së patrajtuar, nga bashkia në masën 50 % të vlerës sipas nenit 41 të Ligjit Nr.45 date 18.07.2020 "Per Mbrojtjen Civile" dhe VKM Nr.329 date 16.05.2012, kreu III , pika 3, germa ç , diferenca për trajtim nga programi “**Emergjencave Civile**”, është **548289** leke.
5. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e PPECK dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava

